



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 39/1 Prot.

Tiranë, më 09.01.2024

V E N D I M

Nr. 12, Datë 09.01.2024

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, bazuar në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar,² mori në shqyrtim ankesën nr. 235, datë 27.10.2023, të shtetasit S. C, kundër Zyrës Postare Shqiptare Nr. 15, Tiranë, me pretendimin për diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit pala ankuese shpjegon se, është person me aftësi të kufizuar dhe në datën 18.10.2023, rreth orës 14:00, ka shkuar për të marrë shërbime në Zyrën Postare Shqiptare nr. 15, Tiranë, por për arsye të mungesës së infrastrukturës së kësaj Zyre Postare nuk ka arritur të marrë shërbimin e kërkuar. Gjithashtu punonjësja e kësaj zyre nuk ka qenë bashkëpunuese që të dilte jashtë dhe të jepte këtë shërbim ankuesit, i cili ishte në pamundësi të hynte brenda.

Bazuar në pamjet fotografike të paraqitura nga pala ankuese, rezulton se, Zyra e Postës Shqiptare sh.a nr. 15, Tiranë, nuk është e aksesueshme dhe në hyrje të saj ka shkallë. Pala ankuese parashtron se, kjo vjen në kundërshtim me nenin 5 “Jetesa e pavarur”, të Ligjit nr. 93/2014 “*Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara*”, i ndryshuar dhe Ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*” i ndryshuar.

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

Sa më sipër, pala ankuese kërkon nga Komisioneri marrjen e masave sipas parashikimeve ligjore në fuqi.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën e sipërcituar, në referencë të kompetencës së parashikuar në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar³, që i atribuon të drejtën të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sikurse parashikohet në këtë ligj.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së⁴, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

Në kreun IV, të LMD, parashikohet një mbrojtje të posaçme nga diskriminimi në fushën e ofrimit të të mirave dhe shërbimeve. Konkretisht, në nenin 20, pika 1, të LMD parashikohet : “1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme,

³ Në vijim do t’i referohemi me akronimin LMD.

ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.”

Parashikimet e bëra në pikën 2, të nenit 20, të LMD, janë orientuese dhe jo shteruese. Referuar objektit të veprimtarisë së ushtruar nga ana e Postës Shqiptare sh.a. të pasqyruar edhe në Regjistrin Tregtar, shërbimet e ofruara nga Posta Shqiptare sh.a., si shërbimet postare, financiare, bankare, ofrimi i shërbimeve bazë të telekomunikacioneve dhe elektronike, apo veprimtaria si agjent në tregun e sigurimeve, si dhe institucion i parasë elektronike, janë shërbime të cilat ofrohen dhe janë të hapura për publikun në përgjithësi, të cilat hyjnë në fushën e veprimit të nenit 20, të LMD.

Shoqëria Posta Shqiptare sh.a, me numër të identifikimit të subjektit (NUIS) J61924007N, është krijuar dhe funksionon në bazë të ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 *“Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”*, të ndryshuar, me aksioner të vetëm Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës.⁵ Objekti i aktivitetit të Postës Shqiptare sh.a. është: *“Shërbime postare, financiare dhe bankare, aktiviteti i gjithë shërbimeve bazë të telekomunikacioneve dhe elektronike, botimi i gazetës “Postieri”, aktivitet radiofonik (“Radio Posta”), veprimtari biznesi, etj, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Agjent në tregun e sigurimeve. Institucion i parasë elektronike.”*

Posta Shqiptare sh.a. ofron shërbime publike dhe merr pjesë në sektorin publik. Posta Shqiptare sh.a. edhe pse është në pronësi të shtetit, nuk ushtron funksione, detyra apo kompetenca publike dhe nuk është pjesë e administratës publike. Në kuptim të nenit 7, të LMD, Posta Shqiptare sh.a. është një subjekt privat që ofron shërbime publike dhe jo një autoritet publik.

Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 235, datë 27.10.2023, të shtetasit S. C, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të Ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”* i ndryshuar. Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

Nëpërmjet shkresës me nr. 1200/1 prot., datë 06.11.2023 nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi i është kërkuar informacion dhe dokumentacion provues Postës Shqiptare sh.a., lidhur me pretendimet e subjektit ankues, si më poshtë:

- Informacion nga ana e Zyrës Postare sh.a., nr. 15 Tiranë, lidhur me situatën e pretenduar nga ana e ankuesit.
- Informacion mbi përmbushjen e aspekteve që lidhen me aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara sipas legjislacionit në fuqi, të ndërtesës ku ofrohen shërbimet nga Zyra e Postës Shqiptare sh.a., nr. 15, Tiranë, shoqëruar me dokumentacion përkatës.
- Kur është vendosur ofrimi i shërbimeve nga ana e Postës Shqiptare sh. a. në ndërtesën objekt i kësaj ankese?

⁵ Referuar ekstraktit të publikuar në faqen zyrtare të internetit të Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB): www.qkb.gov.al.

- Çfarë investimesh janë realizuar ndër vite në ndërtesë dhe a kanë prekur këto investime aspekte që kanë të bëjnë me aksesueshmërinë e godinës dhe shërbimeve që ofrohen.
- Çfarë masash janë marrë për evidentimin e nevojave për përshtatshmërinë e ndërtesës dhe shërbimeve që ofrohen në këtë Zyrë Postare? Kopje të dokumentacionit përkatës ku gjejnë pasqyrim masat e marra.
- A është bërë nga ana juaj një planifikim i fondeve të nevojshme për përshtatjen dhe afateve kohore për realizimin e përshtatshmërisë? Kopje të dokumentacionit ku janë bërë planifikimet përkatëse financiare dhe afatet kohore.

Në përgjigje për sa më sipër, Posta Shqiptare sh.a., me anë të shkresës nr. 2229/1 prot., datë 15.11.2023, informoi Komisionerin ndër të tjera se: *“...Zyra Postare nr. 15, që nga momenti i marrë me qira është pajisur me rampë, në kuadër të ofrimit të shërbimit për personat me aftësi të kufizuar dhe është shfrytëzuar edhe nga qytetarë të tjerë, të cilët kanë të njëjtin status me z. C.*

Duke marrë shkas nga ankesa e z. C, si dhe për të ofruar një shërbim sa më cilësor, posaçërisht për personat me aftësi të kufizuara, të cilët shihen me prioritet maksimal nga ana e Shoqërisë “Posta Shqiptare” sh.a., janë marrë masa për ndërtimin e një rampe të re shtesë, përveç asaj ekzistuese, në datën 29.10.2023.

Në lidhje me pretendimin që nga punonjësit e Zyrës Postare nr. 15, nuk kanë qenë bashkëpunues dhe nuk kanë ofruar shërbimin e kërkuar, nga verifikimet e kryera, rezultoi që njëra nga punonjëset e Zyrës Postare ka bërë përpjekje që të kontaktojë me z. C, me qëllim ofrimin e shërbimit kundrejt tij, por ai nuk ka pranuar.

Gjithashtu ju bëjmë me dije se:

Zyra Postare nr. 15, është ambient i marrë me qira nga Filiali i Postës Tiranë prej vitit 2016 dhe për të është investuar ndër vite nga qiradhënësi, sipas kërkesave dhe standardeve të kërkuara nga qiramarrësi, Filiali i Postës Tiranë.

Theksojmë sërish se, duke qenë ambiente me qira dhe jo pronë e Shoqërisë “Posta Shqiptare” sh.a, Filiali i Postës Tiranë nuk mund të kryej planifikime fondesh për realizimin e përshtatshmërisë së saj, e cila është sipas standardeve dhe e realizuar në bazë e në mbështetje të dispozitave ligjore në fuqi. (Bashkëlidhur po ju dërgojmë dhe foto të Zyrës Postare nr. 15, me rampat që ndodhen pranë saj)

Për sa më sipër, Komisioneri me anë të shkresës nr. 1200/2 prot., datë 20.11.2023 i ka përcjellë ankuesit shkresën nr. 2229/1 prot., datë 20.11.2023 të Posta Shqiptare sh.a.

Me e-mailin datë 21.11.2023, ankuesi është sqaruar për përmbajtjen e shkresës nr. 1200/2 prot., datë 20.11.2023, lidhur me vendosjen e një rampe të dytë në Zyrën Postare nr. 15 Tiranë, duke marrë shkas nga shkresa e Komisionerit me anë të cilës ka përcjellë ankesën e z. C. Ndërkohë, në këtë e-mail është sqaruar dhe fakti që, pamjet fotografike të vendosura në dispozicion nga pala

ankuese, janë të vjetra dhe i përkasin një shqyrtimi tjetër administrativ dhe konkretisht ankesës nr. 98, datë 18.09.2020, ankim i cili është bërë nga z. C, për të njëjtën Zyrë Postare.

III. Vlerësimi i fakteve nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Komisioneri ka shqyrtuar çështjen bazuar në situatën e konstatuar, provat dhe informacionin e administruar gjatë procedurës administrative të zhvilluar.

Shtetasi S. C, është i datëlindjes 15.02.1988 dhe është person me aftësi të kufizuar, fakt ky që rezulton i provuar sipas Vendimit nr.4564, datë 18.10.2022 të Shërbimit Social Shtetëror, sipas të cilit ai është përfitues i statusit paraplegjik Grupi i I-rë, prej datës 01.12.2022 deri më datën 01.12.2027. Ankuesi S. C, është i pajisur me Librezën nr.07844 të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror.

Ankuesi pretendon se, në datën 18.10.2023, rreth orës 14.00, ka shkuar për të marrë shërbime në Zyrën Postare Shqiptare nr.15, Tiranë dhe për shkak të mungesës së infrastrukturës, si dhe mungesës së bashkëpunimit nga ana e punonjësës së Zyrës Postare, nuk ka arritur të marri shërbimin pranë kësaj zyre postare.

Në lidhje me pretendimet e ankuesit, Posta Shqiptare sh.a., me anë të shkresës nr. 2229/1 prot., datë 15.11.2023, prapësoi duke parashtruar se, Zyra Postare nr. 15 është e pajisur me rampë në kuadër të ofrimit të shërbimit për personat me aftësi të kufizuar dhe është shfrytëzuar edhe nga qytetarë të tjerë, të cilët kanë të njëjtin status me ankuesin. Duke marrë shkas nga ankesa e z. C si dhe për të ofruar një shërbim sa më cilësor, posaçërisht për personat me aftësi të kufizuara, Posta Shqiptare sh.a informoi se, në datën 29.10.2023, ka marrë masa për ndërtimin e një rampe të re shtesë, përveç asaj ekzistuese.

Në lidhje me pretendimin se punonjësit e Zyrës Postare nr. 15, nuk kanë qenë bashkëpunues dhe nuk kanë ofruar shërbimin e kërkuar nga ankuesi, Posta Shqiptare sh.a prapësoi duke parashtruar se, nga verifikimet e kryera nga ana e tyre, rezultoi që njëra nga punonjëset e Zyrës Postare ka bërë përpjekje që të kontaktojë me z. C, me qëllim ofrimin e shërbimit kundrejt tij, por ai nuk ka pranuar.

Komisioneri kërkoi nga ana e subjektit ankues me *e-mailin* e datës 21.11.2023, nëse është realizuar dhe plotësuar objekti i ankesës së paraqitur pranë Komisionerit. Gjithashtu nga ana e Komisionerit u kontaktua nëpërmjet numrit telefonit, ku u sqarua për hapat e ndërmarra prej tij dhe për ta informuar se në Zyrën Postare nr. 15, Tiranë, tani janë të vendosura dy rampa për aksesueshmërinë e kësaj zyre.

Me *e-mailin* e datës 19.12.2023, nga ana e Komisionerit është kërkuar nga ankuesi prononcimi në lidhje me aksesueshmërinë e dy rampave të vendosura tashmë nga ana e Shoqërisë Posta

Shqiptare sh.a, në Zyrën Postare nr. 15, Tiranë, si dhe u kërkua informacion nëse është paraqitur pranë saj për të marrë shërbimet e nevojshme.

Nga ana e ankuesit nuk u depozituan parashtrime apo kundërshtime me shkrim në lidhje me sa më sipër.

Ndërkohë, nga shqyrtimi i fotove të vëna në dispozicion në cilësinë e provës nga ankuesi, rezultoi se ato janë foto të vjetra dhe i përkasin një shqyrtimi tjetër administrativ dhe konkretisht ankesës nr. 98, datë 18.09.2020, ankim i cili është bërë nga z. C, për të njëjtën Zyrë Postare. Në lidhje me këtë ankesë me Vendimin nr. 21, datë 03.03.2021, Komisioneri ka vendosur: *“Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative të nisur, lidhur me shqyrtimin e ankesës së z. Sokol Caka, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin është iniciuar procedura hetimore”*.

Kuadri ligjor i zbatueshëm

Me ligjin nr. Nr. 108/2012 *“Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”*⁶, Shqipëria ka ratifikuar Konventën e OKB-së *“Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”*⁷. Bazuar në nenin 116, të Kushtetutës, ky akt ndërkombëtar i të drejtave të njeriut jo vetëm që bëhet pjesë e të drejtës së brendshme e detyrueshme për t’u zbatuar, por duke patur edhe përparësi ndaj ligjeve të tjera.

KDPAK përfaqëson standardin më të lartë të mbrojtjes së të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Qëllimi i kësaj Konvente është të promovojë, mbrojë dhe sigurojë që të gjithë personat me aftësi të kufizuara të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të promovojë respektin e dinjitetin e tyre të lindur (neni1).

Konventa nuk jep një përkufizim të aftësisë së kufizuar, por pranon se aftësia e kufizuar është një koncept evolues dhe se aftësia e kufizuar rezulton nga ndërveprimi ndërmjet personave me dëmtime dhe barrierave/pengesave të qëndrimit/mentalit dhe ambientit që pengojnë pjesmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri në nivel të barabartë me të tjerët (Preambula e KDPAK, gërma “e”). Rrjedhimisht në qendër të vëmendjes nuk duhet të jetë paaftësia/paafhtësitë e mundshme, por kufijtë që ngre shoqëria, duke penguar gëzimin e të drejtave. Nga ana tjetër KDPAK pranon diversitetin e personave me aftësi të kufizuara.

⁶ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën KDPAK.

⁷Ratifikuar me ligjin nr. Nr. 108/2012 *“Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”*.

Me qëllim që të bëhet e mundur që të gjithë personat me aftësi të kufizuar të mund jetojnë në mënyrë të pavarur dhe të marrin pjesë plotësisht në të gjitha aspektet e jetës, shtetet duhet të marrin masat e duhura për të siguruar akses për personat me aftësi të kufizuar, në baza të barabarta me të tjerët, në ambientet fizike, transport, informacion dhe komunikim, përfshirë dhe teknologjitë dhe sistemet e informacionit dhe komunikimit, si dhe në mjete apo shërbime të tjera të hapura apo të siguruara për publikun, si në zonat urbane dhe ato rurale. Këto masa, të cilat duhet të përfshijnë identifikimin dhe eliminimin e pengesave dhe barrierave për mundësimin, zbatohen ndër të tjera për: a) ndërtesa, rrugë, transport dhe mjete të tjera në ambiente të brendshme apo të jashtme, përfshirë shkollat, strehimin, shërbime mjekësore apo vendet e punës; b) informacion, komunikim dhe shërbime të tjera, përfshirë shërbimet elektronike dhe shërbimet e emergjencës. (neni 9/1 KDKPAK).

Aksesueshmëria ose e thënë ndryshe heqja e pengesave/barrierave, është një parakusht që personat me aftësi të kufizuara të marrin pjesë në baza të barabarta me të tjerët në shoqëri, për të jetuar në mënyrë të pavarur, për të gëzuar gjithë të drejtat dhe liritë e parashikuara. Për rrjedhojë, aksesueshmëria është ngushtësisht e lidhur me barazinë dhe mosdiskriminimin e personave me aftësi të kufizuara. Aksesueshmëria duhet të sigurohet për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, pavarësisht nga lloji i aftësisë së kufizuar. Për rëndësinë që aksesueshmëria paraqet, parashikohet nga KDKPAK si një e drejtë më vete në nenin 9, por edhe si një nga parimet themelore që përshkon të gjithë Konventën, sipas nenit 3.

Në pikën 2, të nenit 9, të KDKPAK, parashikohet se: “2. Shtetet palë duhet gjithashtu të marrin masat e duhura: a) për të zhvilluar, shpallur dhe monitoruar implementimin e udhëzimeve dhe standardeve minimale për mundësimin e mjeteve dhe shërbimeve të hapura apo të siguruara për publikun; b) për të siguruar se subjektet private që ofrojnë mjete dhe shërbime, të cilat janë të hapura apo të siguruara për publikun, të marrin parasysh të gjitha aspektet e arritshmërisë dhe shfrytëzimit për personat me aftësi të kufizuara; c) për të siguruar trajnim për pjesëmarrësit në proces lidhur me çështjet e heqjes së barrierave që ndeshin personat me aftësi të kufizuara;...”

Në frymën e Konventës, është miratuar, ligji nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”.(në vijim ligji nr. 93/2014) Në nenin 3, pika 9, të ligjit të sipërcituar, përcaktohet se: “9. “Persona me aftësi të kufizuara” janë individët që kanë dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale ose ndijore, dëmtime të cilat, në bashkëveprim me pengesat e ndryshme, përfshirë ato mjedisore dhe të qëndrimit, mund të pengojnë pjesëmarrjen e plotë dhe efikase të këtyre personave në shoqëri, në kushte të barabarta me të tjerët.”

Në nenin 3, pika 1, të ligjit nr. 93/2014, përcaktohet: “Aksesueshmëri” është mënjanimi i pengesave të të gjitha llojeve”. Më tej në pikën 3, të këtij neni parashikohet se: “ 3. “Pengesat” nënkupton: a) pengesat sociale, veçanërisht qëndrimet, stereotipet e sjelljen tutelore; b) pengesat mjedisore, përfshirë vështirësitë në komunikim që kanë personat me dëmtime ndijore, veçanërisht ata me dëmtime në shikim dhe dëgjim, ata për të cilët komunikimi verbal është i kufizuar ose i pamundur e personat që kërkojnë formate të thjeshta për t’u lexuar dhe për t’u

kuptuar; c) pengesat infrastrukturore, përfshirë ato në banesa, hapësira dhe shërbime publike; ç) pengesat institucionale, përfshirë ato në legjislacion dhe politika”.

Në përputhje me qasjen e KDPAK edhe ky ligj sanksionon se aksesueshmëria është një nga parimet e këtij ligji (neni 3/ç) dhe se jetesa e pavarur e personave me aftësi të kufizuara mund të sigurohet nëpërmjet garantimit të aksesueshmërisë, ndër të tjera ofrimin e shërbimeve. (neni 5/1)

Për mënjanimin e pengesave mjedisore dhe infrastrukturore, Këshilli i Ministrave ka miratuar Vendimin nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”.(në vijim VKM nr. 1074/2015) Ky vendim përcakton masat për zbatimin dhe unifikimin e rregullave, në bazë të të cilave mënjanohe pengesat mjedisore dhe infrastrukturore për të bërë të mundur aksesin në strehim, transport, shëndetësi, kujdes social, arsimim, punësim dhe shërbime për personat me aftësi të kufizuara. Sipas këtij vendimi, janë pengesa infrastrukturore: a) pengesat fizike si burim vështirësish për lëvizjen e kujtudo dhe në mënyrë të veçantë të atyre që, për çfarëdolloj arsyeje, kanë një aftësi lëvizëse të kufizuara, të përhershme ose të përkohshme; b) pengesat që kufizojnë ose pengojnë këdo në përdorimin komod dhe të sigurt të hapësirave, pajisjeve e të pjesëve përbërëse; c) mungesa e mjeteve dhe e sinjalizimeve që lejojnë orientimin dhe njohjen e vendeve e të burimeve të rrezikut për këdo dhe, në veçanti, për personat me shikim apo dëgjim të kufizuara (Kreu I, pika 3). Ky vendim është i detyrueshëm si ndaj sektorit publik ashtu edhe atij privat, përfshin si ndërtesat e reja ashtu edhe ato ekzistuese, e në mënyrë të veçantë ato mjedisore ku ofrohen shërbime publike. (Kreu I, pika 4).

Sipas pikës 2, të kreut 2, të kësaj VKM-je, çdo kërkesë teknike për përshtatshmërinë e objekteve të reja dhe atyre ekzistuese, parqeve, shesheve dhe rrugëve zbatohet sipas dispozitave të parashikuara në vendimin nr. 1503, datë 19.11.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara” (në vijim VKM nr. 1503/2008/Rregullore).

Në Kreun IV, të Pjesës së Dytë, të Rregullores, përcaktohen standardet dhe zgjidhjet teknike të detyrueshme për t’u zbatuar, me qëllim për të garantuar mundësinë e hyrjes dhe përshtatshmërinë e ndërtesave nga ana e personave me aftësi të kufizuara. Konkretisht në nenin 8, të kësaj Rregulloreje, përcaktohen në mënyrë të detajuar standardet funksionale dhe të përmasave në ndërtesa, të detyrueshme për t’u respektuar. Në pikën 2.11, të nenit 8 të Rregullores, parashikohet:

“ 2.11 Platformat e pjerrëta (rampat)

Konsiderohet i arritshëm kalimi i një disnivele deri në 320 cm nëpërmjet platformave të pjerrëta të vendosura njëra pas tjetrës. Rampa duhet të plotësoj kushtet:

- pjerrtësi të lejuar deri në 1:20 (5%);

- gjerësi së paku 120 cm në hapësirat e jashtme, gjegjësisht më së paku 90 cm në hapësirat e brendshme;

- shesh pushime horizontale me dimensione minimale prej 150 x 150 cm ose 140 x 170 cm në drejtim të tërthortë dhe 170 cm në drejtim gjatësor nga ana e kundërt e lëvizjes, e vendosur në çdo 10 m të gjatësisë së rampës,
 - sipërfaqe relievore kundër rrëshqitëse;
 - rrethim të ndërtuar me dorëza mbajtëse në pjesën e pambrojtur, ose në pamundësi një bordurë të paktën me 10 cm lartësi;
 - dorëzë mbajtëse me diametër 4 cm, e formatuar në mënyrë që mund të kapet me pëllëmbë, e vendosur në dy lartësi - prej 60 cm dhe 90 cm;
 - rrethim i rampës, i cili gjendet në hapësirat e jashtme, dorëza mbajtëse e tij e realizuar në mënyrë të tillë që të mos jetë e ndryshme nga ndryshimet termike ;
 - rrethim me sipërfaqe prej qelqi i shënuar dukshëm;
 - përdorim i shenjave të përshtatjes sipas fig. 1.5, 1.7 dhe 1.8 të shtojcës A.
- Përcaktimet dhe kushtet e rampave janë paraqitura në figurën 6 të shtojcës B*
Pjerrësia e platformave nuk duhet t'i kalojë 8%. Janë të pranueshme pjerrësi

Referuar parashikimeve të mësipërme të bëra në VKM nr. 1503/2008 dhe bazuar në objektin e veprimtarisë tregtare të Postës Shqiptare sh.a, ekzistojnë rregulla dhe standarde të mirëpërcaktuara dhe të detyrueshme për zbatim, të cilat duhet të përmbushë ndërtesa ku ushtron veprimtarinë e saj Zyra Postare Tirana 15, për të eliminuar pengesat/barrierat dhe për të garantuar aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuar.

Garantimi i aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar, sikurse më sipër rezulton, kërkon aplikimin e një sërë standartesh dhe kriteresh teknike, të cilat janë miratuar me VKM nr. 1503/2008. Është respektimi në tërësinë e tyre, i këtyre standardeve dhe kriterëve teknike që mundëson heqjen e barrierave/pengesave për personat me aftësi të kufizuara dhe mundëson që personat me aftësi të kufizuar të kenë akses dhe të përfitojnë në baza të barabarta me të tjerët nga shërbimet e ofruara nga Posta Shqiptare sh.a në Zyrën Postare Tirana nr.15.

Pa i hyrë një vlerësimi të detajuar të përmbushjes së kriterëve dhe standardeve të rampës së vendosur në hyrje të Zyrës Postare Nr.15, që është objekt i kësaj ankese, bazuar në pamjet fotografike të vendosura në dispozicion nga Posta Shqiptare sh.a, konstatohet se rampa nuk plotëson të gjitha kriteret e miratuara si më sipër nga Rregullorja, sikurse është rrethimi i rampës me dorëza anësore mbajtëse.

Sipas KDPAK, edhe pse sigurimi i aksesit në mjedisin fizik, transport, informacion dhe komunikimi dhe shërbimet e hapura për publikun është shpesh një parakusht për gëzimin efektiv të të drejtave të ndryshme nga personat me aftësi të kufizuara, sigurimi i aksesueshmërisë mund të arrihet përmes realizimit progresiv.

Kjo qasje parashikohet edhe në nenin 4, të ligjit nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”, në bazë të të cilit është miratuar VKM nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim

dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara". Në këtë VKM, parashikohet se planifikimi për realizimin e përshtatjes, nga ana e subjekteve të detyruara, do të realizohet në mënyrë progresive (Kreu I, pika 12). Sipas pikës 10, të kreut I, të VKM-së, parashikohet gjithashtu se: *"Në planin e masave përfshihet detyrimi i subjektit për: a) evidentimin e objekteve ekzistuese dhe të shërbimeve, për të cilat nevojitet përshtatshmëria; b) planifikimin progresiv të fondeve të nevojshme për përshtatjen; c) përcaktimin e afatit kohor për realizimin e përshtatshmërisë."*

Vendimi nr. 1074/2015 vijon më tej duke parashikuar në pikat 9, 10, 13 dhe 14 të tij se: *"9. Çdo subjekt, që ofron shërbime për publikun, është i detyruar që të miratojë një plan masash për zbatimin e kërkesave të këtij vendimi brenda 6 (gjashtë) muajve nga hyrja e tij në fuqi. 10. Në planin e masave përfshihet detyrimi i subjektit për: a) evidentimin e objekteve ekzistuese dhe të shërbimeve, për të cilat nevojitet përshtatshmëria; b) planifikimin progresiv të fondeve të nevojshme për përshtatjen; c) përcaktimin e afatit kohor për realizimin e përshtatshmërisë. 13. Çdo subjekt, sipas pikës 4, të këtij vendimi, ka detyrimin që, brenda 12 (dymbëdhjetë) muajve nga data e miratimit të planit të masave, të fillojë punën për të realizuar procesin e përshtatshmërisë lidhur me objektet ekzistuese dhe shërbimet e ofruara."*

Realizimi progresiv do të thotë se heqja e pengesave dhe sigurimi i aksesueshmërisë duhet të sigurohet në mënyrë të vazhdueshme dhe sistematike, por në çdo rast në mënyrë të qëndrueshme, efektive dhe brenda një kornize afatshkurtër dhe afatmesme.

Referuar Komentit të Përgjithshëm Nr.2 (2014), mbi nenin 9 "Aksesueshmëria", të miratuar nga Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, si autoriteti përgjegjës i ngarkuar nga KDPAK për interpretimin e kësaj Konvente, parashikohet se: *"E drejta për aksesueshmëri për personat me aftësi të kufizuara sigurohet përmes zbatimit të rreptë të standardeve të aksesueshmërisë. Pengesat për të hyrë në objektet ekzistuese, ambjentet, mallrat dhe shërbimet e synuara ose të hapura për publikun duhet të hiqen gradualisht në një mënyrë sistematike dhe, më e rëndësishmja, të monitoruar vazhdimisht, me qëllim që të sigurohet aksesueshmëria e plotë"*.

Komenti i Përgjithshëm Nr.2 (2014), mbi nenin 9 "Aksesueshmëria", i miratuar nga Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar, përcakton se: *"Si minimum, situatat e mëposhtme në të cilat mungesa e aksesit ka penguar një person me aftësi të kufizuara të ketë akses në një shërbim ose objekt të hapur për publikun, duhet të konsiderohen si akte të ndaluara të diskriminimit të bazuar në aftësinë e kufizuar: (a) Kur shërbimi ose objekti është krijuar pasi janë prezantuar standardet përkatëse të aksesueshmërisë; (b) Aty ku aksesit mund të ishte dhënë në objekt ose shërbim (kur ai u krijua) nëpërmjet përshtatjes së arsyeshme....."*

Bazuar në provat e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës rezultoi e provuar se, Zyra Postare nr. 15, ishte e pajisur me rampë, në kuadër të ofrimit të shërbimit për personat me aftësi të kufizuar. Për të njëjtën zyrë postare ankuesi ka depozituar edhe më parë ankesë në vitin 2021,

për mungesë aksesueshmërie të kësaj zyre. Me vendimin nr. 21, datë 03.03.2021, Komisioneri ka deklaruar të përfunduar procedurën administrative lidhur me shqyrtimin e ankesës që ankuesi ka paraqitur në vitin 2021, pasi ishte arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin kishte iniciuar procedura hetimore. Vendimi nr.21, datë 03.03.2021, i Komisionerit nuk rezulton të jetë kundërshtuar në gjykatë nga ana e ankuesit.

Rezultoi e provuar në bazë të akteve të vendosura në dispozicion nga Posta Shqiptare sh.a se, duke marrë shkas nga ankesa e z. C, nga ana e subjektit Posta Shqiptare sh.a në datën 29.10.2023 është ndërtuar një rampe e re shtesë, përveç rampës që ekzistonte më parë.

Në bazë të pretendimeve të parashtruara në ankesën objekt shqyrtimi, ankuesi pretendon se është diskriminuar për shkak të mungesës së aksesueshmërisë në zyrën postare të cilën ai e lidh me rampën, si dhe mungesën e bashkëpunimit nga punonjësit e zyrës postare që të dilte jashtë dhe t'ia jepte këtë shërbim ankuesit, i cili pretendon se ishte në pamundësi të hynte brenda godinës ku ofrohen shërbimet, për një episod të ndodhur në datën 18.10.2023.

Posta Shqiptare sh.a e kundërshtoi pretendimin e ankuesit për mungesë bashkëpunimi nga ana e punonjësve ndërsa gjatë shqyrtimit pretendimi i ankuesit nuk rezultoi i provuar.

Pas paraqitjes së ankesës së parë nga ana e ankuesit të bërë në vitin 2021, si rezultat i të cilës Posta Shqiptare sh.a mori masa për ta pajisur Zyrën Postare Nr.15 me rampë dhe deri në momentin e paraqitjes së ankesës objekt shqyrtimi, ankuesi nuk ngre asnjë pretendim për mosmarrjen e shërbimeve pranë kësaj zyre postare për mungesë aksesueshmëri në lidhje me rampën.

Garantimi i aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara, kërkon aplikimin e një sërë standartesh dhe kriteresh teknike. Është respektimi në tërësinë e tyre, i këtyre standardeve dhe kriterëve teknike që mundëson heqjen e barrierave/pengesave për personat me aftësi të kufizuara dhe mundëson që personat me aftësi të kufizuara të kenë akses dhe të përfitojnë në baza të barabarta me të tjerët nga shërbimet e ofruara. Komisioneri nuk ka si qëllim të vlerësojë nëse janë përmbushur ose jo të gjitha standardet dhe kriteret teknike, por të vlerësojë dhe gjykojë nëse mungesa e tyre e ka privuar ankuesin nga marrja e shërbimit.

Në kushtet dhe rrethanat e çështjes konkrete, Komisioneri vlerëson se, mungesa e ndonjë aspekti që ka të bëjë me standarte dhe kriteret teknike, sikurse në rastin në fjalë rrethimi me doreza mbajtëse i rampës në Zyrën Postare Nr.15, Tiranë, nuk rezulton të ketë çuar në një dështim diskriminues nga ana e subjektit Posta Shqiptare sh.a për të marrë masa të mjaftueshme për të korrigjuar pabarazitë faktike në mënyrë që t'i mundësojë ankuesit dhe të gjithë personave me aftësi të kufizuara të marrin në baza të barabarta me të tjerët shërbimet e ofruara nga ana e këtij subjekti. Rezulton se, Posta Shqiptare sh.a ka bërë përpjekje të konsiderueshme për përmirësimin e aksesit në këtë zyrë postare. Komisioneri vlerëson se, përmirësimet e aksesueshmërisë që janë bërë, tregojnë një përkushtim për të punuar drejt realizimit gradual të aksesueshmërisë sipas të gjitha standardeve dhe kriterëve në fuqi.

Referuar Komentit të Përgjithshëm Nr.2 (2014), mbi nenin 9 “Aksesueshmëria”, të miratuar nga Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, parashikohet se:

“.....25. Aksesueshmëria lidhet me grupet, ndërsa përshtatja e arsyeshme lidhet me individët. Kjo do të thotë se detyra për të ofruar akses është një detyrë ex ante. Prandaj, shtetet palë kanë për detyrë të ofrojnë aksesueshmërinë përpara se të marrin kërkesa individuale për të hyrë ose përdorur një vend ose shërbim..... Standardet e aksesueshmërisë duhet të jenë të gjera dhe të standardizuara..... Në përputhje me Konventën, shtetet palë nuk lejohen të përdorin masat shtrënguese si justifikim për të shmangur sigurimin e aksesueshmërisë graduale për personat me aftësi të kufizuara. Detyrimi për të zbatuar aksesueshmërinë është i pakushtëzuar, pra subjekti i detyruar që të sigurojë aksesueshmërinë nuk mund të justifikojë mosveprimin për t'a siguruar atë, duke iu referuar barrës për sigurimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara. Detyrimi për përshtatjen e arsyeshme, përkundrazi, ekziston vetëm nëse zbatimi nuk përbën barrë të tepruar për subjektin.

26. Detyra për të ofruar përshtatje të arsyeshme është një detyrë ex nunc, që do të thotë se është e detyrueshme që nga momenti kur një individ me dëmtim ka nevojë për të në një situatë të caktuar..... Këtu, standardet e aksesueshmërisë mund të jenë një tregues, por mund të mos merren si urdhërues. Përshtatja e arsyeshme mund të përdoret si një mjet për të siguruar akses për një person me aftësi të kufizuara në një situatë të caktuar.....”.

Gjatë shqyrtimit të ankesës, nuk rezultoi që ankuesi, të ketë paraqitur ndonjë kërkesë për përshtatje të arsyeshme, e cila të jetë mohuar në mënyrë të pabazuar nga Posta Shqiptare sh.a.

Komisioneri bazuar në prova dhe fakte vlerëson se, në lidhje me Zyrën Postare nr. 15, Shoqëria Posta Shqiptare sh.a, arriti të provojë se ka marrë masa për të realizuar në mënyrë progresive aksesueshmërinë e saj, për personat me aftësi të kufizuara.

Përfundimisht, Komisioneri arrin në përfundimin se, ankuesi z. S. C, nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë nga ana e Postës Shqiptare sh.a në lidhje me pretendimet e parashtruara në ankesë për sa i përket marrjes së shërbimeve pranë Zyrës Postare nr. 15, Tiranë. Në mungesë të trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë, Komisioneri arrin në përfundimin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese dhe shkelje të dispozitave të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

- 1.** Konstatimin e mosdiskriminimit të ankuesit z. S. C, për shkak aftësisë së kufizuar, nga ana e Postës Shqiptare sh.a, në lidhje me ofrimin e shërbimeve nga ana e saj pranë Zyrës Postare Tirana Nr.15, Tiranë.
- 2.** Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Konceptoi: L. Jani, Inspektore DHA
Rishikoi: K. Keta, Inspektor DHA
Konfirmoi: V. Bushati, Drejtore DHA
Datë: 04.01.2024